

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA E KOSOVËS PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE - AKPPM**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **7200-22-14624-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me banderolla**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.
NUI	810493057
Adresa	Arberia 3 Vicianum, C2.2-OB-3-H-89 Nr.24
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044178168
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Flamur Arifi
Adresa elektronike	flamur.arifi@kit-ks.com
Data e parashtrimit të ankesës	30.05.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me banderolla

27.12.2022 B05 Njoftim per Kontrat

15.02.2023 B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve

17.05.2023 B42 Leter Standarde per tenderuesin e eliminuar

17.05.2023 B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues

22.05.2024 Kerkese per rishqyrtim

23.05.2023 Njoftim mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit

24.05.2023 Vendim ndaje kerkeses per rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Me date 15.02.2023 eshte bere Hapja e tendereve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 22.05.2023 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim te Autoriteti Kontraktues – AKPPM

Me datë 24.05.2023 kemi pranuar pergjigje ne Kerkesen tone per Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP Nr. 04/L-042 Qëllimi
- Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
- Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP Nr. 04/L-042 Kriteret për Dhënien e Kontratës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Permes kesaj Ankese, ne pretendojm qe vendimi i AKPPM per eliminimin e ofertes tone eshte i gabuar dhe i njeaneshem, me te cilin vendim kane eliminuar oferten tone nga gara ne proceduren e prokurimit si te padrejte dhe gjithsesi i pabazuare ne asnje nen te LPP.

Ne me pergjegjesi te plote ri-konfirmojm se tenderi i dorezuar nga ne si GOE, i permbush pa perjashtim, te gjitha kriteret administrative dhe teknike, sipas TD.

Me poshte, do te faktojme me prova qe pretendimet e AK me te cilat jemi shpallur te eliminuar, jane te pabazuara plotesisht dhe tendencioze.

Sipas pretendimit te AK-se mostra e banderoles se **KALTER** ka gjatesi 34.38 mm qe nenkupton se eshte edhe nen tolerancen e lejuar nga AK ne specifikacionin teknik dhe ne jemi eliminuar per kete te gjetur.

Po ashtu sipas pergjigjes nga AK ndaj Kerkese per Rishqyrtim: "komisioni i vleresimit eshte bazuar tek raporti i Agjencis se Kosoves per Forenzike. Ku ne kete raport shifet se mostra jone nuk ka plotesuar njerin nga kriteret e specifikacionit teknik te kerkuar ne TD, konkretisht dimensionet e banderoles qe jane kerkuar ne TD."

Pra, ne nuk kemi asnje raport te tille, prandaj kerkojm te plotesohet ekspertiza/raporti pasi ka mangesi dhe te perseritet matja e banderolave pasi mendojm qe ka ndodhur nje gabim gjate matjes se mostrave tona.

Po ju sqarojm me posht ne menyre faktike dhe me argumente qe dimensionet e banderolave nuk mund te mos jene te sakta pasi prerja e tyre behet teresisht automatike sipas shtancit(shabllonit) te krijuar per keto dimensione nga makina printuese e prodhuesit.

Sipas dosjes se tenderit eshte kerkuar dorezimi i mostrave per banderolla te kuqe si dhe banderolla te kalterta se paku nga 50 cope, ne i kemi dorezuar ato sipas kerkese, po ju njoftojm qe per keto mostra te banderolave eshte bere prerja duke e perdorur makinen printuese "Spilker GmbH" nga shtanci(shablloni) i njejt per te dy banderolat, si ato te kuqe dhe te kalterta, pra eshte

prerje automatike nga shtanci(shablloni) i krijuar per keto dimensione. Si rrjedhoje eshte e pamundur qe nga shtanci(shablloni) i njejt i prerjes te kete gabim ne dimensione per banderolen e **KALTER** kurse per banderolen e **KUQE** te jete ne rregulle, sipas raportit qe ju keni. Me posht kemi sjellur argumente tjera qe tregojn shtancin(shabllonin) se si funksionin gjate procesit te prerjes, mostrat qe jane dorezuar, si dhe argumente teknike per makinen printuese.

Argumenti 1:

Sipas dokumentit i cili edhe eshte i ngarkaur ne TD këto kërkesa janë të përmbushura nga ana jonë (shih dokumentin: 04_001 A4_Kosovo_KMA_2023.pdf)

Ne kete dokument është specifikuar saktë banderola me foto, dizajni i prodhuesit, skicat e zmadhuara të cilat tregojnë elementet mbrojtëse për banderolat e kuqe si dhe te kalterta, si dhe dimensionet e banderolave.

Argumenti2:

Ne jemi furnizues i banderolave per AKPPM per periudhen 2019 -2022 nga e cila kontrate kemi furnizuar:

1. Banderola te kalterta 123,499,829 copa
2. Banderola te kuqe 20,000,000 copa

Pra ne kemi furnizuar me shume se 140mil cope banderola te printuar nga prodhuesi DEMAX sipas makines printues me emrin "Spilker GmbH" me "Specification for flexible dies" nga e cili shabllon jane prodhuar te gjitha banderolat si te kuqe dhe te kalterta.

Po ju njoftojm qe eshte e pamundur te behet nje gabim ne dimension kur prerja e banderolave behet ne menyre automatike nga shablloni i krijuar veqmas per kete projekte (per kete kemi futur nje foto per sqarim shtese se si funksionon makina per printim).

Po ashtu ju njoftojm qe kriteri i dimensioneve te banderolave ka qene i njejt edhe ne dosjen e 2019, me titull "Furnizim me banderola-Ritender" dhe nr. prokurimi "7200-19-1757-1-1-1" ku ne kemi dorzuar mostrat nga e njejta makine printuese dhe nga shablloni i njejt dhe kemi kaluar me sukses kete kriter.

Argumenti3:

Ne kete pergjigje kemi bashkengjitur keto dokumente qe faktojn gjendjen aktuale se banderolat tona jane sipas dojes se tenderit dhe me dimensionin te sakta.

Dokumentet:

- 001 Matje e banderolës nga prodhuesi sipas shabllonit.pdf
- 002 Shablloni per printim te banderol me dimensione 35-20mm.pdf
- 003 Specifikimet për matricat e shabllonit per prerje.pdf
- 004 Banderolat e dorzuar per moster 2023.pdf
- 005 Banderolat e dorzuar per moster 2019.pdf

Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, që të marr vendim meritor, me të cilin urdhëron AK që:

1. Të anuloj Njoftimin mbi vendimin e AK të datës: 24.05.2023
2. Të kthej lëndën në rivlerësim

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e fitimit të parashikuar nga kontrata

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.